



**MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE E MBROJTJES SOCIALE
DREJTORIA E SHERBIMIT SPITALOR POGRADEÇ
NJËSIA E PROKURIMIT**

Pogradec me 22 Korrik 2025

Procesverbal- tipi i kontratës – mall

Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike, termat e references dhe kriterëve për kualifikim

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale **per nevojat e Drejtorise se Sherbimit Spitalor Pogradec”(MM2)_Marreveshje kuader me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara me afat 12 muaj.**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):Materiale mjekesore te konsumueshme-33140000-3

VLERA E FONDIT LIMIT:Fondi limit/vlera e pritshme e kontratave:7,016,747.90 leke(shtatemilioneqjasht-embedhjetmijeeshtateqindedyzeteshtatepikenentedhjet) pa tvsh,

Fondi limit ështëpërlllogaritur bazuar në V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 76 nen titullin “Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit” pika 1. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon: germa c)çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

Përlllogaritja e fondit limit është dokumentuar me relacionin mbi argumentimin e perlllogaritjes se fondit limit ,specifikimeve teknike, kriterëve per kualifikim nga njesia e prokurimit.

Burimi i Financimit :Me te ardhurat e Buxhetitte Shtetit.

Forma juridike e finalizimit të procesit të prokurimit do të jetë;**Marrëveshje Kuadër me 1 Operator Ekonomik, kur të gjitha kushtet janë të përcaktuara.** Me qellim garantimin e furnizimeve ne afatet kohore te percaktuara , MK me nje OE te vetem fitues do te garantoje sigurine e furnizimeve sipas kushteve te percaktuara dhe brenda afateve te kerkuara duke sjelle stabilitet ne menaxhimin e kontratave dhe te nevojave te AK.

Autoriteti/enti Kontraktor-**Drejtoria e Sherbimit Spitalor Pogradec** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 8.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor **Drejtoria e Sherbimit Spitalor Pogradec** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbeshtetje në nenin 82 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.*

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilën është e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit

Argumentimi: Kriteri i mësipërm bazohet në nenin 77 të LPP-se

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022,2023,2024) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të përlllogaritur.

Nëse operatorët ekonomikë, arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këto DT, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur

Argumentimi: Ky kriter, është vendosur në përputhje me:

- Piken 3, të nenit 77, të Ligjit nr 162/2020, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci të tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*
- Piken 1 dhe 2/c, të nenit 43, të VKM-se 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar në të cilin gjejmë të përcaktuar se: *1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontratën, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.*
2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e

shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme.

- Piken 3, te nenit 43, të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar, ne te cilen gjejmë te percaktuar se: *Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*
- Piken 5, te nenit 43, të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar, ne te cilen gjejmë te percaktuar se: *Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Legjislatori në ne piken 1 dhe piken 2/c te nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, te ndryshuar ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohe në Procedurën e Hapur te thjeshtuar ku percaktohet; Pika 2/c: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohe operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar,; Referuar ne vleren e fondit limit te kesaj procedure AK ka menduar se vendosja e nje vlere minimale te xhiros **sa 40 % e vlerës sëfondit limit*, eshte nje deshmi e mjaftueshme per te krijuar** bindjen tek Autoriteti Kontraktor se Operatoret Ekonomike ofertues zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohe, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 ‘Mbi Rregullat e Prokurimit Publik’ te ndryshuar ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe nenit 61 të Ligjit nr. 29, datë 30.03.2023 ‘Për Tatimin Mbi të Ardhurat’ i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratën tatimore vjetore; (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Në rastin e përvojes së mëparshme të realizuar në sektorin publik, autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të

legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në:

- Nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” ne te cilën gjejmë te përcaktuar se: *4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*
- Si dhe bazuar ne nenin 55, pika 4/b, të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ne te cilin citohet si vijon: *b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më të vogël se 20 % të vlerës së përlogaritur fondit limit të procedurës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme kërkohej për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK. duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar marrëveshjen kuadër, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë ISO 9001:2015 /ose/ ekuivalent ISO 13485 ”Per Sistemin e menaxhimit të cilësisë” /ose ekuivalent/ të vlefshme, për prodhuesit e artikujve të ofruar, **ose në rastin kur OE ofertues nuk është prodhues të paraqesë Vetëdeklarim ku të deklarojë se furnizuesi është konform Standardeve të Cilësisë.** Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.”

Çertifikata kërkohet të jetë origjinale ose të perkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Shenim: Ky kriter në fazën e ofertimit të operatoreve ekonomik do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin/paraqitjen e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST-ve

Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla*”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet:

Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 44, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, lidhur me dëshmitë për rezultatet e testeve zyrtare të lëshuara nga institucione të autorizuar që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. Ky kriter është i lidhur ngushtë me objektin e kësaj kontrate si dhe me aftësinë zbatuese të kontratës, me garantimin e kapaciteteve profesionale dhe të cilësisë nga OE pjesëmarrës.

Kërkohet certifikim i prodhuesit për të provuar se mallrat e ofertuara plotësojnë kërkesat e cilesise sipas percaktimit të pikës 1, të nenit 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” ku percaktohet se: Autoriteti ose enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që Autoriteti ose enti kontraktor të vërtetojë se furnizimet objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Bazuar në këto dispozita Autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon: a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara; b) efikasitetit të energjisë; c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.

- ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime me të ulta.

ISO 9001:2015 përfaqëson standartin ndërkombëtar unanim i njohur si standarti që i perket kërkesave për një sistem menaxhimi të cilesise. Ky standart aplikohet për çdo shoqëri pavarësisht madhësisë ose fushës së aktivitetit

2.3.3 Ofertuesi duhet të jetë i certifikuar me ISO 9001:2015, ose ekuivalente” **Per sistemet e menaxhimit të cilesise**”, për fushën e veprimtarisë që përfshin objekti i prokurimit. Certifikata kërkohet të jetë origjinale ose e perkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Për këtë ai duhet të paraqesë certifikatën perkatese të vlefshme

Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, neni 44, pika 1, të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Ky kriter është i lidhur ngushtë me objektin e kësaj kontrate si dhe me aftësinë zbatuese të kontratës, me garantimin e kapaciteteve profesionale nga OE pjesëmarrës si dhe rekomandimit të APP nr. 8197 datë 03.09.2018 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, pune, shërbime”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që Autoriteti ose enti kontraktor të vërtetojë se furnizimet objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Bazuar në këto dispozita Autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon: a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara; b) efikasitetit të energjisë; c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në

zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime me të ulta.

ISO 9001:2015 përfaqëson standartin ndërkombëtar unanim i njohur si standarti që i përket kërkesave për një sistem manaxhimi të cilësive. Ky standart aplikohet për çdo shoqëri pavarësisht madhësisë ose fushës së aktivitetit

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikata konformiteti CE ose FDA **ose ekuivalente / të barasvlershme me to** për artikujt e ofruar, sipas kategorizimit të tyre. Certifikata kërkohet të jetë origjinale ose të perkthyer në gjuhën shqipe dhe e noterizuar e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Shenim: Ky kriter në fazën e ofertimit të operatoreve ekonomik do të konsiderohet i permbushur me dorëzimin/paraqitjen e formularit përmbledhës të vetdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST-ve

Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet:

Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi: Ky kriter vendoset në përputhje me pikën 6/c të nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, lidhur me dëshmitë për rezultatet e testeve zyrtare të lëshuara nga institucione të autorizuar që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. Certifikimi CE i këtyre materialeve është aplikuar në zbatim të Ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”(nenit 17 dhe 18) si dhe rekomandimit të APP-se nr. 7998 datë 24.12.2021 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime”, si dhe rekomandimeve të APP-se për vendosjen e FDA-se.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë vendin e prodhimit të mallit dhe kompaninë prodhuese (të plotësohet në shtojcën 3“Lista e çmimeve të artikujve” të DST)

Argumentimi: Ky kriter është vendosur me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese për të identifikuar atë gjatë lëvrimit të tij dhe për të patur sigurinë që i njëjti mall i ofertuar do të lëvrohet në destinacion në përputhje me nenin 40, pika 6 dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik,pasi deklarata mbi origjinën e mallit (kompaninë prodhuese dhe vendi prodhimit) është kërkuar në mënyrë që me anë të saj të bëhet krahasimi i ofertës, materialeve që ofertohen nga OE me autorizimin e prodhuesit dhe dokumentacionin teknik që do të paraqitet në SPE.

Nga këndvështrimi teknik, vetëdeklarimi i origjinës së mallit dhe kompanisë prodhuese/MAH është thelbësor për sigurinë e furnizimit dhe për të garantuar cilësinë e materialeve të mjekimit

Kjo kërkesë:

- **Siguron gjurmueshmëri dhe transparencë:** Deklarimi i origjinës dhe i kompanisë prodhuese ndihmon në identifikimin e çdo problem të mundshëm gjatë shpërndarjes, duke parandaluar rreziqet që lidhen me materialet e mjekimit të falsifikuara ose me cilësi të ulët.
- Kriteri për vetëdeklarimin e origjinës së mallit dhe kompanisë prodhuese/MAH është i domosdoshëm për të siguruar transparencën, sigurinë dhe cilësinë e artikujve të kërkuar.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese/ MAH /ose nga Distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi për territorin e Shqipërisë,ku në çdo rast të provohet/ dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin ,nepermjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregetojë artikujt objekt prokurimi. Autorizimi kërkohet të jetë origjinal i perkthyer në gjuhën shqipe,ose kopje e perkthyer dhe e noterizuar, i vlefshëm në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi: Ky kriter vihet në përputhje me nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” lidhur me kualifikimin profesional dhe aftësinë teknike (aftësia teknike) si dhe pika 3 e nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me qëllim zotërimin e aftësisë dhe besueshmërisë për zbatimin e kontratës si dhe bazuar në Ligjin 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”. Nga këndvështrimi teknik, autorizimi i kompanisë prodhuese/MAH është thelbësor për sigurinë e furnizimit dhe për të garantuar cilësinë e materialeve të mjekimit

Kjo kërkesë:

- **Siguron gjurmueshmëri dhe transparencë:** Autorizimi i kompanisë prodhuese ndihmon në identifikimin e çdo problem të mundshëm gjatë shpërndarjes, duke parandaluar rreziqet që lidhen me materialet e mjekimit të falsifikuara ose me cilësi të ulët.
- Kriteri për paraqitjen e autorizimit të mallit nga kompanisë prodhuese/MAH ose nga Distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi për territorin e Shqipërisë është i domosdoshëm për të siguruar transparencën, sigurinë dhe cilësinë e artikujve të kërkuar.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim të vlefshëm për tregtim të pajisjeve mjekësore të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë sipas ligjit 89/2014 datë 17.07.2014 “Për pajisjet mjekësore”

Argumentimi: Ky kriter vihet në përputhje me nenin 21 “Autorizimi për tregtim të pajisjeve mjekësore” i Ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”.

2.3.8 Kërkohen të paraqiten katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofertuar ku të jene pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara për secilin artikull. Në katalogë, artikujt dhe specifikimet teknike të tyre duhet të shenohen me numër rendor sipas numrit rendor të artikullit në *Shtojcën 3, Lista e cmimeve të artikujve*. Në katalog artikujt dhe specifikimet teknike të tyre duhet të markohen me ngjyrë të ndezur sipas numrit rendor të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogët duhet të ngarkohen në www.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DST.

(pjesët e katalogut që përmbajnë emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohej, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të perkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen).

Argumentimi: Ky kriter vendoset në përputhje me pikën 6/b të nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, lidhur me dëshmitë për fotografitë ose katalogët teknikë

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **oferten teknike**, për artikujt objekt prokurimi sipas numrit rendor në Shtojcën 3 “Lista e cmimeve të artikujve” në formë tabele, ku të pasyrohet: Emertimi i artikullit, Specifikimet teknike, Emri i kompanisë prodhuese, Origjina e mallit, Emertimi i katalogut të artikullit / produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, Numri i referencës së artikullit (kodi) nxjerre nga katalogu i prodhuesit, si dhe çertifikimet perkatese për produktet.

Numri i faqes ku ndodhet: Autorizimi i prodhuesit, certifikata ISO, CE ose FDA, të perkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara për secilin artikull të ofertuar.

Argumentimi: Ky kriter vendoset në përputhje me pikën 8, të nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Autoriteti/enti kontraktor, ku përcaktohet se: *AK-ja përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës*

2.3.10 Operatori ekonomik të paraqesë një vetedeklarim në rast se shpallet i sukseshëm “***Të gjitha pajisjet mjekësore, që vendosen në treg në Republikën e Shqipërisë, duhet të regjistrohen në Regjistrin Kombëtar të Pajisjeve Mjekësore, që mbahet nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore në përputhje me nenin 13, të Ligjit 89/2014, i ndryshuar.***”

Argumentimi: Ky kriter vendoset bazuar në nenin 13 të Ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”.

Shënim për operatorët ekonomik:

Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet: “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla*”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet:

Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

• CERTIFIKATAT E CILËSISË

Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

II. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Cilesojme faktin se specifikimet teknike për objektin: Blerje materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale për nevojat e Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Pogradec“(MM2) janë të unifikuara në nivel kombëtar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe zbatohen njelloj për të gjitha institucionet shëndetësore publike në Shqipëri me qëllim standartizimin e cilësive të furnizimeve lehtësimin e procedurave të prokurimit dhe garantimin e një trajtimi të barabartë për pacientet në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor.

Njesia e prokurimit në këtë relacion është orientuar edhe nga specifikimet teknike, bazuar në procedurat e ngjashme të pasqyruara në sistemin elektronik të APP-së nga Spitali Rajonal Elbasan me nr. reference të procedurave: REF-35448-01-16-2025, Spitali Rajonal Gjirokastrë me numur reference të procedurave: REF-40782-03-11-2025, Spitali Rajonal Durrës me numur reference të procedurave: REF-46917-05-05-2025, Spitali Rajonal Shkoder me numur reference të procedurave: REF-42384-03-25-2025, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Sarandë me numur reference të procedurave: REF-44753-04-11-2025, si dhe procedurat e realizuara nga MSHMS-ja.

Në seksionin e specifikimeve teknike, komisioni vendosi të njëjtat specifikime teknike dhe sasi të kërkesa të përcaktuara nga hartuesit e specifikimeve teknike të dokumentuara sipas relacionit për përllogaritjen e fondit limit të hartuar nga grupi i punës.

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat objekt procedure prokurimi, duke përllogaritur sasi të nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standartet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve në nenin 4, pika 38/b, nenin 36 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, nenin 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohej nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent". Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve: **Materiale mjekimi Konsumi dhe kirurgjikale -MM2**

Nr	Artikulli	Specifikime	Njesia
	Materiale mjekimi per Anestezi -reanimacion		
1	Kanjule intravenoze	14G , me valvol	Copë
2	Kanjule intravenoze	16G , me valvol	Copë
3	Kanjule intravenoze	18G , me valvol	Copë
4	Kanjule intravenoze	20G , me valvol	Copë
5	Kanjule intravenoze	22G , me valvol	Copë
6	Kanjule intravenoze	24G, me valvol	Copë
7	Age mielogramme me doreze	Tip troakar, 16-18G, L=75-90 cm,me doreze regjistruese	Copë
8	Age spinale e zakonshme	22G - 26G, L=7-9 cm	Copë
9	Age spinale atraumatike	Pencil point; 22G - 26G; L=7-9cm	Copë
10	Ventil tre-rugesh		Copë
11	Ventil tre-rugesh me zgjatues	Tub 10-25 cm gjatesi	Copë
12	Kateter Foley 2-rruge	Silikon Foley Ped-adult 2-rruge 12G-20G	Copë
13	Sonde gastrike		Copë
14	Sonde rektale pediatrike		Copë
15	Qese urine	2000ml, me valvol	Copë
16	Kanjule trakeostomie 100% silikon	7,7.5,8,8.5 mm me ballon	Copë
17	Kateter urinar	2 rugesh, 12 ch, balon 10 ml	Copë
18	Kateter urinar	2 rugesh, 16 ch, balon 30 -50 ml	Copë
19	Kateter urinar	2 rugesh,20 ch, balon 30-50 ml	Copë
20	Kateter urinar	2 rugesh, 18 ch, balon 30-50 ml	Copë
21	Kateter urinar	2 rugesh, 14 ch, balon 30-50 ml	Copë
22	Shiringa 50cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile , me Age 20 G , 3 pjese,	Copë
23	Shiringa 20cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile , me Age 20 G , 3 pjese,	Copë
24	Shiringa 10cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile , me Age 21 G , 3 pjese,	Copë
25	Shiringa 5cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile , me Age 22 G , 3 pjese,	Copë
26	Shiringa 2cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile , me Age 23G , 3 pjese,	Copë
27	Shiringa insuline	Sterile, tre pjeseshe, me Age 26G	Copë
28	Age 18G	sterile	Copë
29	Age 20G	sterile	Copë
30	Age 21G	sterile	Copë
31	Age 23G	sterile	Copë
32	Age flutur 18G	sterile	Copë
33	Age flutur 20G	sterile	Copë
34	Age flutur 22G	sterile	Copë
35	Shiringa 50cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile me gryke hinke	Copë
	Materiale nje perdorimeshe per kirurgji		
36	Maske kirurgjikale	Cope e pathurur me 3 shtresa, celuloze , poliester , fiber , koficenti i filtrimit ≥ 99 % , me pershtates per hundën dhe lidhese , dimesionet 90 mm x 180 mm , pesha 2.8 gr /m2	Copë
37	Kapele kirurgu	Cope e pathurur me peshe jo me pak se 25 gr.m ² , me lidhese poshte qafes, pa latex.	Copë
38	Kapuc per infermjere	Cope e pathurur me peshe jo me pak se 25 gr.m ² me fund elastik , pa latex.	Copë
39	Qese per veshje kepucesh	Qese PVC, me mbyllje elastike	Copë
40	Beze kirurgjikale sterile 50x75cm	Cope e pathurur, e veshur me polietilen, joinvazive, me peshe jo me pak se 35g/m ² , me permasa 50x75cm	Copë
41	Beze kirurgjikale aktive 7.5 cm x 7.5 cm	Cope e thurur, me thithje te shpejte per plage, me perberes polyakrylate (SAP) me veshje celuloze and solucion ringer, 7.5 cm x 7.5 cm ose ekuivalent	Copë

42	Beze kirurgjikale sterile 75x90cm	Cope e pathurur, e veshur me polietilen, joinvazive, me peshe jo me pak se 35g/m2, me permasa te copes 75x90cm	Copë
43	Beze kirurgjikal sterile me vrimë 200 x 250 cm	Cope e pathurur e veshur me polietilen, jo invazive, me peshe jo me pak se 35 gr/m ² , me vrimë rrethore , me diameter 10 cm , me buze adesive, me permasa te copes 200 x 250 cm	Copë
44	Beze kirurgjikale sterile me vrimë 75x90cm	Cope e pathurur, e veshur me polietilen, joinvazive, me peshe jo me pak se 35g/m2, me vrimë rrethore , diameter 5 cm , me buze adesive, me permasa te copes 75x90cm	Copë
45	Beze kirurgjikale sterile me vrimë (100 x 150cm)	Cope e pathurur, e veshur me polietilen, joinvazive, me peshe jo me pak se 35g/m2, me vrimë rrethore , me diameter 10 cm , me buze adesive, me permasa te copes 100 cm x 150 cm .	Copë
46	Beze me vazeline	Beze me pomade te thjeshte (vazeline te bardhe, estere acid yndyror digliceroli te karbonateve dhe bikarbonateve, dyll sintetik) e pershkueshme nga ajri dhe eksudati, me shtrese te trashe qe nuk fshihet dhe ne rast te eksudatit masiv, jo alergjike, efektive dhe per trajtim afatgjate. 7.5cm x10 cm ose ekuivalent	Copë
	Materiale qepes kirurgjikale		
	Sutura mendafshi		
47	Silk -USP 1, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 40-50	me age 1/2 rrethore	Copë
48	Silk -USP 2-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 30-35	me age 1/2 rrethore	Copë
49	Silk -USP3-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-30	age 1/2 rrethore prerese	Copë
50	Silk -USP4-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-30	me age 1/2 rrethore shpuese	Copë
51	Silk -USP5-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 17-22	me age 1/2 rrethore shpuese	Copë
52	Silk -USP5-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 17-22	me age 1/2 rrethore prerese	Copë
53	Nylon- USP 4-0; Gjatesia fijes 45-50 cm; Dimensioni i ageve 14-15	Monofilament I tejdukshem, age 3/8 rrethore, reverse cutting, slip point	Copë
	Sutura Sintetike te Absorbueshme		
54	Poliglctin ose PGA , Coated- USP 1; Gjatesia e fijes 70-90 cm; Dimensioni i ageve 40-50	me age 1/2 rrethore	Copë
55	Poliglctin ose PGA , Coated- USP 0; Gjatesia e fijes 70-90 cm; Dimensioni i ageve 40-50	me age 1/2 rrethore	Copë
56	Poliglctin ose PGA , Coated- USP 2- 0; Gjatesia e fijes 70-90 cm; Dimensioni i ageve 30-40	me age 1/2 rrethore	Copë
57	Poliglctin ose PGA , Coated- USP 3- 0; Gjatesia e fijes 70-90 cm; Dimensioni i ageve 20-30	me age 1/2 rrethore	Copë
58	Poliglctin ose PGA , Coated- USP 4- 0; Gjatesia e fijes 70-90 cm; Dimensioni i ageve 20-30	me age 1/2 rrethore	Copë
59	Poliglctin ose PGA , Coated-USP5-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 17-22	me age 1/2 rrethore	Copë
60	Poliglctin ose PGA , Coated-USP6-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 17-22	me age 1/2 rrethore	Copë
61	Poliglctin ose PGA , Coated- USP 2- 0; Gjatesia e fijes 2.5 m	me ligature pa age	Copë
62	Poliglctin ose PGA , Coated- USP 3- 0; Gjatesia e fijes 2.5 m	me ligature pa age	Copë
63	Poliglctin ose PGA , Coated me absorbim te shpejte- USP5-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 17-26	me age 1/2 rrethore	Copë
64	Polydioxone-USP 2-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 25-35	me age 1/2 rrethore	Copë
65	Polydioxone-USP 3-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-30	me age 1/2 rrethore	Copë
	Suture Polipropileni		
66	Polypropylene-USP1, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 30-40 mm	1/2 rrethore	Copë
67	Polypropylene-USP1, Gjatesia fijes 75-90cm; dimesnioni i ageve 40-50 mm	1/2 rrethore, cutting	Copë
68	Polypropylene-USP0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 30-40 mm	1/2 rrethore	Copë
69	Polypropylene-USP0, Gjatesia fijes 40-50cm; dimesnioni i ageve 30-40 mm	1/2 rrethore. Shpuese	Copë
70	Polypropylene-USP2-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 25-30 mm	1/2 rrethore	Copë
71	Polypropylene-USP2-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 30-40 mm	1/2 rrethore. Shpuese	Copë
72	Polypropylene-USP3-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-30 mm	1/2 rrethore. Shpuese	Copë
73	Polypropylene-USP4-0, Gjatesia fijes 70-90cm; dimesnioni i ageve 17-22 mm	1/2 rrethore. Shpuese	Copë
	Sutura PVDF e verdhe		

	Mesh kirurgjikal per hernia-laparaskopi.		
74	Mesh e vogel	Pjeserisht e absorbueshme (90-120 dite) me perberje polipropilen dhe PGA dhe koprolakton (PP/PGACL)Fije monofilament; pesha e meshes < 30 g/m2, siperfaqja jo me pak se 150cm2	Copë
75	Mesh e madhe	Pjeserisht e absorbueshme (90-120 dite) me perberje polipropilen dhe PGA dhe koprolakton (PP/PGACL)Fije monofilament; pesha e meshes < 30 g/m2, siperfaqja jo me pak se 900cm2, porozitet > 75 mikron	Copë
76	Polyamide 6 dhe 66- USP 10-0, Gjatesia e fijes 30-45 cm, Dimensioni i ageve 5-8 mm	spatula 1/2ose 3/8 rrethore, double	Copë
	Te tjera materiale qepes kirurgjikale		
	Dezinfektante Mjekesore dhe Kirurgjikale		
77	Dezinfektant instrumentash me baze Glutaraldehide-Formaldehide	Per dezinfektimin manual te instrumenteve kirurgjikale, perfshire endoskopet dhe fibroskopet. Te kete efekt baktericid, fungicid, tuberkulocid, antiviral (perfshire HBV/HIV)Te furnizohet si komplet me solucion e pa - aktivizuar dhe aktivizuesin per perzierjen dhe perftrimin e solucionit te gatshem per perdorim.Permbajtja: min. 2% glutaraldyhe, etj. Te furnizohet si solucion i gatshem per perdorim (max 5 litra / ene). Te kete referenca perdorimi nga firmat e njohura te endoskopeve dhe fibroskopeve	litra
78	Solucion i koncentruar enzimatik	Per pastrimin e mbetjeve ne intrumentat mjekesore-kirurgjikale, vecanerisht endoskopet dhe instrumentat mjekesore dhe kirurgjikale me pjese te levizeshme dhe lumene te vegjel.Te kete baze enzimatiqe. Te furnizohet si koncentrat per tu holluar me uje ne masen 1-3% . Te jete efektiv per pune ne uje me temperature te zakonshme (~20°)	litra
79	Detergjent	Dezinfektim të shpejtë dhe të vazhdueshme të të gjitha sipërfaqeve, plane sanitare, dysheme, dhe objekteve. Dezinfektanti permban 10 % Didecildimetilammonio Cloruro dhe 2 % Isotiazolinone Magnesio Cloruro , perdoret duke u tretur 20 ml ne 1 liter uje	litra
80	Xhel shumeperdorimsh	Per desinfektimin e duarve te personelit mjekesor , Antiseptik i shpejte dhe efektiv , i gatshem për ta përdorur , pa nevojën përdorimit të ujit për shplarje. Te furnizohet ne ene 1 - 3 liter te pajisura me dozator.	litra
81	Chlorhexidine gluconate	4% chlorexidine gluconate; . Antiseptik me efekt baktericid, fungicid, antiviral . Për kirurgët për desinfektimin e duarve , larja e plotë e pacientëve përpara ndërhyrjes kirurgjikale, i gatshem për ta përdorur	litra
82	Peroksid Hidrogjeni 3%	Peroksid hidrogjeni 3% e vëllimit . Për përdorim të te plageve te jashtëme , i gatshëm për ta përdorur	litra
83	Formaldehid	Solucion 35-40%	litra

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Specifikimete teknike te pergjithshme

Afati i skadencës: Jo më të vogël se 12 muaj nga data e lëvrimit të mallit në destinacion.Skadenca duhet të jetë e shënuar në ambalazh.Ambalazhimi të jetë i përshtatshëm sipas llojit të mallit të shoqëruar me etiketat dhe markimin përkatës. Ofertuesi duhet të përmbushë specifikimet teknike të materialeve mjekësorë detyrimisht sipas përcaktimit të bëre në përshkrimin e mallrave në DS të kësaj procedurë prokurimi.Të respektohen specifikimet teknike të kërkuara nga shërbimet për çdo artikull.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Ne kete seance nuk ka mendim kundra, te gjithë anetaret e njesise se prokurimit nenshkruajne rregullisht,hartimin e specifikimeve teknike,kritereve per kualifikim, argumentimin e fondit limit i cili mbahet ne tre kopje.

NJESIA E PROKURIMIT

(emer,mbiomer,nenshkrimi)

(emer,mbiomer,nenshkrimi)

(emer,mbiomer,nenshkrimi)

MIRATOI
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
Erion Thengjilli